
**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
P&P FAÇON GROUP SHPK**

MA

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
P&P FAÇON GROUP SHPK

NENI 1
EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë është “P&P FAÇON GROUP” SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

NENI 2
SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, kati 4, Ap. 10, Njesia Administrative nr. 2, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të çelë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

NENI 3
KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

NENI 4
OBJEKTI I AKTIVITETIT

- 4.1 Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj kryerjen e të gjitha veprimtarive që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë sipas ligjit shqiptar, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, përfshirë por pa u kufizuar në:
- 4.1.1 Zotërimin, administrimin, blerjen, tjetërsimin, transferimin e pjesëmarrjeve dhe interesave në shoqëri të tjera, sipërmarrje ose në ente dhe/ose persona juridikë, në cilëndo formë e mënyrë;
 - 4.1.2 Aktivitetin e financimit dhe administrimit të shoqërive dhe sipërmarrjeve në të cilat zotëron pjesëmarrje ose interesa;
 - 4.1.3 Aktivitete të tjera, jo të përfshira në veprimtaritë e mësipërme, që Shoqëria çmon të kryejë, në respektim të normave ligjore.
- 4.2 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Për realizimin e objektit të aktivitetit saj dhe jo kundrejt publikut, Shoqëria:
- 4.2.1 Mund të zotërojë pjesëmarrje në shoqëri dhe sipërmarrje të tjera, shqiptare

apo të huaja;

- 4.2.2 Mund të kryejë operacione industriale, tregtare, financiare, me pasuri të luajtshme e të paluajtshme që vlerësohen të nevojshme ose të dobishme, përfshirë por pa u kufizuar në dhënien e garancive dhe dorëzanive në favor të bankave, enteve kredidhënëse dhe të tretëve në përgjithësi për detyrimet e veta apo së të tretëve, kërkimin e financimeve dhe huave të çdo lloji, nga banka, ente kredidhënëse dhe të tretë në përgjithësi, dhënien e financimeve sipërmarrjeve dhe shoqërive ku zotëron pjesëmarrje, veprime me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, operacione tregtare dhe çdo aktivitet të lidhur me objektin e aktivitetit të Shoqërisë ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve të veta.

NENI 5 KAPITALI

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Kapitali i regjistruar është plotësisht i nënshkruar dhe i ndarë në një kuotë, që përfaqëson 100% të kapitalit, me vlerë 10.000 (dhjetë mijë) lekë, e zotëruar nga Ortaku i Vetëm shoqëria "PAIMEX" Srl, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Firences (Itali), me kod fiskal dhe numër regjistrimi 06080820480, me seli në Cerreto Guidi (FI), Via della Repubblica 1/3/7, kodi postar 50050, Firenze, Itali.

NENI 6 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet në çdo kohë me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar. Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.

NENI 7 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 7.1 Në përputhje me nenin 81, pika 3, e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar, të drejtat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, përfshirë vendimet në lidhje me:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve ushtrimore;
 - c) vendimet për investime;
 - d) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

- 7.2 Çdo vendim i Ortakut të Vetëm që nuk është regjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.
- 7.3 Ortaku i Vetëm vendos për të gjitha çështjet e parashikuara në nenin 81 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 7.4 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencë dhe/ose videokonferencë, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 7.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga administratori ose nga ortakët, në përputhje me parashikimet e nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas ligjit. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim, email ose letërporosi, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht në rast se, pavarësisht respektimit të formaliteteve të mësipërme, të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë dakord për rendin e ditës dhe vendimmarrjen për çështjet përkatëse.
- 7.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga kryetari, i zgjedhur ndërmjet të pranishmëve. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 7.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 7.8 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 8 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 8.1 Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një administrator i vetëm, i zgjedhur nga Ortaku i Vetëm për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori i Vetëm mund të rizgjidhet ose të shkarkohet nga Ortaku i Vetëm. Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë Av. Jori Bregasi, shtetas shqiptar, i lindur dhe me banim në Tiranë, i pajisur me letërnjoftimin nr. 034193776, nr. personal I80410080T, i caktuar në detyrë nga data e këtij akti e deri më datë 30.06.2026.

- 8.2 Administratori i Vetëm gëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori i Vetëm do të marrë miratimin paraprak me shkrim të Ortakut të Vetëm për të gjitha veprimet e administrimit të jashtëzakonshëm, përfshirë por pa u kufizuar, si tjetërsimi ose blerja e pasurive të paluajtshme, huamarrja dhe financimet, lëshimi i garancive dhe dorëzanive, blerja dhe shitja e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera. Administratori mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimtarinë e të tretëve që ka deleguar.
- 8.3 Administratori i Vetëm vepron në respektim të politikave tregtare dhe të direktivave të Asamblesë së Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Administratori i Vetëm do të ndjekë udhëzimet dhe direktivat e dhëna nga Ortaku i Vetëm edhe nëse këto direktiva kanë të bëjnë me veprime të veçanta administrimi.
- 8.4 Ortaku i Vetëm përcakton shpërblimin e organit administrues të Shoqërisë.
- 8.5 Ortaku i Vetëm mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorin e Vetëm, pa pasur të drejtë ky i fundit të kërkojë shpërblim ose dëmshpërblim, përveç pagesave të maturuara deri në datën e shkarkimit.

NENI 9 KONTROLI FINANCIAR

- 9.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 10 VITI FINANCIAR

- 10.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të Shoqërisë, i cili fillon në datën e themelimit të Shoqërisë dhe mbyllet më datë 31 dhjetor 2025.

NENI 11 BILANCI VJETOR DHE DIVIDENDI

- 11.1 Ortaku i Vetëm miraton bilancin vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit mbi ecurinë e veprimtarisë dhe raportet e audituesit ligjor (nëse është emëruar).
- 11.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Ortaku i Vetëm brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

- 11.3 Ne përputhje me dispozitat ligjore, Ortaku i Vetëm vendos mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë.

NENI 12
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 12.1 Dispozitat ligjore në fuqi do të zbatohen në rast prishjeje dhe likuidimi të Shoqërisë.

NENI 13
LIGJI I ZBATUESHËM

- 13.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme dhe këtë Akt Themelimi e Statut. Dispozitat e ligjit nr. 9901/2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar, do të zbatohen në rastet e paparashikuara nga ky Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 14
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 14.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve do të gjykohen nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 15
TË NDRYSHME

- 15.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën italiane dhe në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhjes ndërmjet dy versioneve gjuhësore të këtij akti, versioni në gjuhën italiane do të ketë epërsi.

Nënshkruar në Cerreto Guidi (FI), Itali, më datë 9 qershor 2025.

ORTAKU I VETËM

shoqëria PAIMEX s.r.l.
E përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit të Administrimit
Znj. Lorian Meacci





Via della Repubblica, 1/3/7
50050 STABBIA CERRETO GUIDI (FI)
Tel 0571 586443 Fax 0571 956800
C.F. e P.IVA 06080820480